



BASHKIA  
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

# Tirana kryeqyteti european i rinisë 2022

Raport përmbledhës i sondazhit



Prill 2021

<i>Grafiku 1. Demografia .....</i>	4
<i>Grafiku 2. A jeni në dijeni që Tirana është shpallur kryeqyteti i rinisë për vitin 2022 .....</i>	5
<i>Grafiku 3. Mendoni se çmimi është një zhvillim pozitiv për kryeqytetin .....</i>	5
<i>Grafiku 4. Si i vlerësoni investimet, nismat dhe aktivitetet në mbështetje të rinisë .....</i>	6
<i>Grafiku 5. A do të merrni pjesë apo do të ndiqni një osë më shumë nga këto aktivitete .....</i>	6
<i>Grafiku 6. Cilat nga qëllimet që synon të përmbushë programi do të realizohen më tepër .....</i>	7

## Hyrje

Tirana është qyteti i 14-të që fiton çmimin “Kryeqyteti Rinor European” duke triumfuar pas një gare të fortë me 4 qytete të tjera finaliste si: Baia Mare (Rumani), Kazan (Rusi), Poznań (Poloni) dhe Varaždin (Kroaci). Bashki nga e gjithë Europa patën mundësinë të aplikojnë në këtë konkurs, ku secili prezanton me video, shembuj dhe argumente përse meriton të jetë kryeqytet rinor europian, duke treguar vençantitë e identitetit dhe forcës së rinisë.

Tirana u prezantua me një video të mrekullueshme me dy breza, brezi i parë me shumë fëmijë dhe pastaj të rinj që flasin në disa gjuhë të huaja. Stafi i Bashkisë së Tiranës punoi për më shumë se një vit për suksesin e arritur. Në vazhden e përgatitjeve paraprake për pritjen e titullit, Kongresi Rinor Kombëtar, si strukturë rinore mbështetëse e këtij titulli, dhe Bashkia e Tiranës, si qytet aplikues, patën nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi që i paraprin zbatimit të kësaj ngjarjeje në vitin 2022.

Aplikimi ishte në një linjë me prioritetet e Bashkisë së Tiranës për rrijtëzimin e kapaciteteve kulturore, artistike, sociale, ekonomike dhe edukative të të rinjve.

Bashkia Tiranë do të nisë me përgatitjen e një kalendari aktivitetesh për ta kthyer këtë vit në një vit ku Tirana të dëgjohet në mbarë Europën. Në përputhje me sloganin ‘Active’ janë planifikuar projekte inovative dhe gjithëpërfshirëse, që nxisin frymën e aktivizmit tek të rinjtë dhe ushqejnë potencialin e tyre. Rinia ka një rol të rëndësishëm në Europë për mbrojtjen e vlerave të padiskutueshme siç janë kultura, demokracia, klima, ekologjia.

Si Kryeqyteti European i Rinisë 2022, Tirana do të ketë një program ambicioz që do të synojë të adresojë nevojat e të gjithë të rinjve të saj dhe do të përpiqet të lidhë qytetin dhe rininë e tij me vlerat europiane.

Tirana do të tregojë se është një vend europian, njësoj si dhe shumë qytete të tjera në Bashkimin European dhe me bujarinë, buzëqeshjen, mikpritjen shqiptare, me zell, pasion, edhe me energji, do të jetë gati për të bërë performancën më të mirë.

## Qëllimi dhe objektivat e sondazhit

Qëllimi i këtij sondazhi është të evidentojë nëse qytetarët janë në dijeni të çmimit që ka fituar Bashkia e Tiranës, vlerësimin për investimet dhe nismat e ndërmarra për rininë si edhe pritshmëritë lidhur me aktivitetet që parashikohen.

Ky sondazh synon të nxjerrë në pah:

1. Masën në të cilën qytetarët janë të informuar në lidhje me shpalljen e Tiranës, kryeqyteti europian i rinisë 2022;
2. Opinionin për zhvillimet që do të sjellë ky çmim;
3. Vlerësimin për një sërë investimesh, nisma dhe organizime në mbështetje të aktiviteteve rinore, të ndërmarra nga Bashkia e Tiranës;
4. Nëse qytetarët do të kishin dëshirë të merrnin pjesë apo të ndjekin një ose më shumë nga aktivitetet që do të zhvillohen përgjatë vitit 2022;
5. Cilat nga qëllimet për të cilat synon të organizohet programi mendojnë se do të realizohen më tepër.


## REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT

Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total e të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së mendimit qytetar.


Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:

**Të dhëna mbi demografinë (rreth 700 qytetarë të anketuar)**


*Grafiku 1. Demografia*




*Grafiku 2. A jeni në dijeni që Tirana është shpallur kryeqyteti i rinisë për vitin 2022*




*Grafiku 3. Mendoni se çmimi është një zhvillim pozitiv për kryeqytetin*




**Grafiku 4. Si i vlerësoni investimet, nismat dhe aktivitetet në mbështetje të rinisë**



**Grafiku 5. A do të merrni pjesë apo do të ndiqni një osë më shumë nga këto aktivitete**



**Grafiku 6. Cilat nga qëllimet që synon të përmbushë programi do të realizohen më tepër<sup>1</sup>**



<sup>1</sup> Për sa i përket shifrave dhe të dhënave në përqindje, rezultati në grafikë i paraqitur në këtë pyetje, si shumë totale mund të mos jetë i barabartë me 100% për shkak të mundësisë për të shprehur më shumë se një alternativë brenda të njëjtës pyetje.

# ANEKS 1 – PYETËSORI I SONDAZHIT



BASHKIA  
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

## PYETËSOR PËR SHPALLJEN E TIRANËS “KRYEQYTETI RINOR EUROPIAN 2022”

Nr. i pyetësorit \_\_\_\_\_

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

### SEKSIONI I: Të dhëna demografike

Nj.A. /Lagje e qytetarit	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)			
	F	M	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

### SEKSIONI II: Pyetje

1. A jeni në dijeni që Tirana është shpallur kryeqyteti European i rinisë për vitin 2022?(*Bashki nga e gjithë Europa kanë patur mundësinë të aplikojnë në këtë konkurs, ku secili prezanton me video dhe shembuj, argumente përse meriton të jetë kryeqytet rinor europian, duke treguar vençantitë e identitetit dhe forcës së rinisë*).

Po     Jo     Pa përgjigje

2. Mendoni se çmimi që Bashkia e Tiranës mori zyrtarisht në Amiens të Francës, mes 5 qyteteve kandidate, është një zhvillim pozitiv për kryeqytetin?(*Për një vit, Tirana do jetë Kryeqyteti European i Rinisë, çka do të thotë shumë projekte, shumë aktivitete, një promovim i jashtëzakonshëm i Tiranës dhe Shqipërisë, dhe shumë mundësi për të rinjtë tanë për t'u organizuar dhe lidhur me gjithë rrjetet rinore europiane*).

Po     Jo     Pjesërisht     Pa përgjigje

3. Si i vlerësoni një sërë investimesh, nismadhe organizime në mbështetje të aktiviteteve rinore, të ndërmarra nga Bashkia e Tiranës: (*Tirana Art Fest, Java Europiane, Ditët e hapura të edukimit të BE, Ditët Rinore të Start Up-eve, Ditët e Rrjetëzimit të të Rinjve dhe Bizneseve, fokusin që ka pasur tek të rinjtë duke filluar me çerdhet, kopshtet, shkollat, këndet e lodrave, rikonstruksionin e konvikteve, apo krijimin e një sërë lehtësirave që ofron tashmë karta e studentit*).

Aspak mirë     Jo mirë     Mesatarisht     Mirë     shumë mirë     Pa përgjigje



4. Do të kishit dëshirë të merrnit pjesë apo të ndiqni një ose më shumë nga këto aktivitete?(Përgjatë një viti qyteti bëhet qendra e mbi 500 aktiviteteve për të rinjtë e kryeqytetit dhe jo vetëm dhe merr një vizibilitet të jashtëzakonshëm).

Po  Jo  Ndoshta  Pa përgjigje

5. Cilat nga qëllimet për të cilat synon të organizohet programi mendoni se do të realizohen më tepër:

Nr.rendor	Qëllimet që duhet të përmbushin aktivitetet	Përzgjidh (më shumë se 1)
1	Krijon mundësi të reja për të rinjtë për t'u organizuar dhe lidhur me gjithë rrjetet rinore europiane etj.	
2	Sjell ndryshime pozitive, sa i përket projekte ve dhe aktiviteteve promovuese për Tiranën, etj.	
3	Inkurajon pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e të rinjve në proceset e vendimmarrjes etj.	
4	Promovon vullnetarizmin nëpërmjet përfshirjes të të rinjve si vullnetarë në aktivitetet që do të organizohen në kuadër të European Youth Capital	
5	Nxit identitetin europian	
6	Mbështet larmishmërinë dhe përfshirjen	
7	Forcon organizatat rinore	
8	Rrit investimet për rininë	
9	Përforcon zërin në Europë	
10	Shndërron qytetin në një pikë takimi ndërkombëtar	
11	Lidh të rinjtë mes tyre	

*Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionin e qytetarëve lidhur me shpalljen e Tiranës "Kryeqyteti Europian i Rinisë 2022". Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".*

*Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësisht të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.*

## ANEKS 2 – LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR

1. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Ligji nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, miratuar në datën 18.9.2014.
3. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
4. Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"”.